



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:122375

Datë: 16.11.2021

Numri i dokumentit: 02403136

C.nr.1967/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni civil, gjyqtari Berat Spahiu, me bashkëpunorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen juridike të paditëses Q.S nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Flakron Abdullahu avokat nga Gjilani, kundër të paditurës K.Gj, të cilën me autorizim e përfaqëson Burim Maliqi, Zyrtar Ligjor në Zyrën e Avokatit të Komunës së Gjilanit, me objekt kontesti kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, të udhëtimit dhe shpërblimit jubilar, vlera e objektit: 1.770.90 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe jopublik/ për shkak të pandemisë Covid -19/ të mbajtur me datë 10.11.2021, merr këtë;

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar me ligj, kërkesëpadija e paditëses Q.S nga Gjilani dhe detyrohet e paditura K.Gj, që paditëses, t'ia paguaj shumën e të hollave në emër të shpërblimit jubilar për mbi 40 vite përvojë pune në vlerë të 150% një page baze, në lartësi prej 631.50 €, kurse në emër të kompensimit të shujtave të ushqimit, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 28.09.2021, respektivisht për 422 ditë të pranisë në punë, shumën e të hollave në lartësi prej 844.00 euro, €, si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 422 ditë punë nga 1€ apo 70% të bilëtes së trafikut urban shumën prej 295.40€, respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,770.90 euro, duke e llogaritur kamatën prej 8% në vit, nga data 28.09.2021 / data e ushtrimit të padisë/ e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

II. Detyrohet e paditura K.Gj, që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 270 €, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja Q.S nga Gjilani, përmes përfaqësuesit të saj me autorizim Flakron Abdullahu avokat nga Gjilani, në këtë Gjykatë ka ushtruar padi ndaj të paditurës K.Gj, duke kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija e paditëses ashtu që të detyrohet e paditura K.Gj, që paditëses, t'ia paguaj shumën e të hollave në emër të shpërblimit jubilar për mbi 40 vite përvojë pune në vlerë të 150% një page baze, në lartësi prej 631.50 €, në emër të kompensimit të shujtave të ushqimit, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 28.09.2021, respektivisht për 422 ditë të pranisë në punë, shumën e të hollave në lartësi prej 844.00 euro, €, si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 422 ditë punë nga 1€ apo 70% të bilëtes së trafikut urban shumën prej 295.40€, respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,770.90 euro, duke e llogaritur kamatën prej 8% në vit nga data 28.09.2021 / data e ushtrimit të padisë/ e deri në pagesën

definitive, të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

Përfaqësuesi i paditëses ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës duke i specifikuar ato edhe ate 104 € për përpilimin e padisë, 31 € për takës gjyqësore si dhe 135 € për përfaqësim në një seancë gjyqësore.

Përfaqësuesi me autorizim i të paditurës, në përgjegjëje në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses duke theksuar se Gjykata Themelore në Gjilan nuk ka kompetencë lëndore për të gjykuar rastin, meqë e kompetencës lëndore është Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Qështje Administrative e poashtu ka theksuar se K.Gj nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, meqë nënshkrues të Kontratës së lartcekur janë MASHT-i/ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë/ dhe SBASHK-u/ Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës/ dhe se kontrata kolektive nuk prodhon efekte juridike për të padituren, ngase e paditura nuk është nënshkruese e Kontratës.

Poashtu e njëjta e ka kundërshtuar padinë nga nuk është ushtruar brenda fatit prej 30 ditëve dhe nuk janë shtjerrur mjetet e brendshme juridike konform nenit 80 të Ligjit të Punës. Po ashtu e njëjta e ka kundërshtuar padinë nga se në rastin konkret kemi parashkrim të kërkesë pasiqë tash paditësja ka 44 vite përvojë të punës , ndërsa dihet se një e drejtë e tillë i ka takuar pasi që paditësja i ka bërë 40 vite përvojë të punës, që do të thotë një kërkesë të tillë e ka bërë pas 4 viteve, e që vërtetohet përmes listës së pagave të cilën paditësja e ka sjellë si provë të bashkangjitur me padi. Po ashtu e njëjta ka theksuar se e drejta për kompenzim të shpërblimit jubilar realizohet në vitin kur arrihet viti jubilar dhe jo kur është gjetur e përshtatshme.

Gjykata analizoi secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe vërtetoi se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar me ligj, ashtu që Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të Aktgjykimit duke e detyruar të paditurën që paditëses, t'ia paguaj shumën e të hollave në emër të shpërblimit jubilar për mbi 40 vite përvojë pune në vlerë të 150% një page baze, në lartësi prej 631.50 €, në emër të kompensimit të shujtave të ushqimit, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 28.09.2021, respektivisht për 422 ditë të pranisë në punë, shumën e të hollave në lartësi prej 844.00 euro, €, si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 422 ditë punë nga 1€ apo 70% të biltës së trafikut urban shumën prej 295.40€, respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,770.90 euro, duke e llogaritur kamatën prej 8% në vit, nga data 28.09.2021 / data e ushtrimit të padisë/ e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

Kërkesat e paditëses bazën ligjore e kanë në nenin 35, paragrafi 5, 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë / *Kontrata nr. 24 e dt. 18.04.2017/* ngase në nenin përkatës në mënyrë shprehimore është përcaktuar se: *Punëtorët (antarë të SBASHKUT-ut) në vitin jubilar të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënsi i fundit, në vlerë: për 10 vite të përvojës së punës shpërblimin 50% të një page bazë, për 20 vite të përvojës së punës shërblimin 75% të një page bazë, për 30 vite të përvojës së punës shërblimin në vlerë të një page bazë, për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150% të një page bazë “ kurse në bazë të nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës në mënyrë shprehimore është përcaktuar se „të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompenzimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është dy /2/ € për të punësuarit që kanë mardhënie e punës primare në institucionet arsimore. Me nenin 35 paragrafi 5 i Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar të dt.18.04.2017, është paraparë*

se "Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditën e pranisë në punë.. Gjykata konstaton se edhe me Kontratën Kolektive të Arsimnit të datës 22.01.2021 në nenin 35 janë përcaktuar të njëjtat kushte dhe detyrime për të paditurën.

Në fakt në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësja është mësimdhënëse e shkollimit parashkollor në SHFMU "Skenderbeu" në fshatin Përlepnice, K.Gj, ngase një fakt të tillë e konfirmon edhe Vendimi me nr. të protokolit 335/2 të datës 17.09.2020 lëshuar nga drejtori i shkollës përkatëse, ku është përcaktuar se paditësja ka përvojë të punës 43 vite, 5 muaj e 12 ditë, kurse lista e pagave e lëshuar nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës konfirmon se paditësja pagën bazë e ka 421€, ashtu që asaj konform nenit 35 të Kontratës Kolektive të Arsimnit në Kosovë e duke u mbështetur në përvojën e punës mbi 40 vjeqare i takon kompenzimi i 150% të pagës bazë në lartësi prej 631.50 €.

Poashtu, në bazë të Vërtetimit nr. të protokolit 248 të datës 07.02.2020 vërtetohet se paditësja për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datë 12.09.2019 ka qenë e pranishme në punë për 422 ditë, ashtu që konform nenit 35 të Kontratës Kolektive të Arsimnit në Kosovë, e paditura duhet t'ia kompenzoj shpenzimet e ushqimit ditor nga dy/2/ euro në ditë, respektivisht në lartësi prej 844.00 €, e poashtu t'ia kompenzoj edhe shpenzimet e udhëtimit në relacionin Gjilan-Përlepnice dhe anasjelltas, 70% të biletës e cila sipas Vërtetimit të datës 03.06.2020 të lëshuar nga SHTU „Anamorava,, në Gjilan, bileta e udhëtimit në këtë relacion dhe anasjelltas kushton 1€ e që 70% i saj është në lartësi prej 295.40 €, konform ditëve të udhëtimit prej 422 ditë.

Faktin e vendbanimit dhe udhëtimit të paditëses në relacionin e cekur me lartë e konfirmon Certifikata e Vendbanimit me numër serik B 10283830 e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjilan.

Sipas pretendimeve të palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese lartësia prej 2 euro e pagesës së shujtave ditore si dhe prania e mësimdhënësit në punë për 422 ditë, por kontestuese sipas të paditurës mbeten faktet nëse Kontrata Kolektive e lartcekur prodhon efekt juridike për të paditurën, meqenëse nuk është nënshkruar nga ana e saj si dhe kërkesa a është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve siq parashihet në nenin 80 të Ligjit të Punës, pastaj parashkrimi i kërkesës si dhe ditët e pranisë në punës pas skadimit të Kontratës Kolektive dmth.pas dt.17.04.2021.

Kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse mbeten faktet nëse kjo gjykatë ka kompetencë lëndore për të gjykuar rastin, pastaj nëse Kontrata Kolektive e lartcekur prodhon efekt juridike për të paditurën meqenëse nuk është nënshkruar nga ana e saj si dhe në rastin konkret a kemi parashkrim të kërkesave konform nenit 87 të Ligjit të Punës /Ligji nr.03/L-2112 i datës 01 Nëntor 2010/ si dhe ditët e pranisë në punës pas skadimit të Kontratës Kolektive dmth.pas dt.17.04.2021.

Lidhur me pretendimet e të paditurës gjykata arsyeton se është e kompetencës lëndore për të gjykuar rastin, pasi që sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Gjykatat e Rregullta/ Ligjinr. 06/L – 054 në nenin 12.1 decidivisht është përcaktuar se „Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe. Kurse Departamenti për Qështje Administrative në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, sipas nenit 17 të Ligjit për Gjykatat gjykon qështjet administrative, respektivisht gjykon sipas padisë për hapjen e konfliktin administrativ, kur kemi një vendim administrativ të formës së prerë ndaj të cilit pala e pakënaqur ushtron padi me qëllim të realizimit të së drejtës së tij subjektive apo kur kemi të bëjmë me heshtje të administratës dhe për kategoritë e punëtorve që

sipas nenit 4 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës/ Ligji Nr. 03/L-149/ mardhënia juridike e të cilëve rregullohet me këtë Ligj, të cilët sipas nenit 82 të Ligjit ndjekin procedurën e realizimit të së drejtës së tyre së pari në Komisionin për Ankesa dhe Parashpresa, pastaj i drejtohen Këshillit të Pavarur Mbikqyrës e mëpastaj me padi i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Qështje Administrative për hapjen e Konfliktit Administrativ, kurs siq dihet të punësuarve në sektorin e arsimit ju garantohet mbrojtje ligjore konform Ligjit të Punës së Kosovës.

Gjykata poashtu konstaton se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditësit edhe pse nuk është nënshkruse e Kontratës Kolektive të Arsimit/*Kontrata nr.24. edatës 18.04.2017/*, pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komunale apo DKA-të.

Gjykata konsideron se nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesave, konform nenit 87 të Ligjit të Punës, ngase Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, ka hyrë në fuqi me datë 17.04.2017, kurse padinë e ka ushtruar me datë 28.05.2020, çka do të thotë se të drejtën e saj e njejtja e ka ushtruar mbrenda afatit prej 3 vite edhe pse neni 87 i Ligjit të Punës është i paqartë kur, citoj „ *Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës, që do të thotë parashkrimi fillon të rrjedhë nga dita e ushtrimit të kërkesës e jo siq duhet të ishte nga dita e ardhjes për pagesë/ maturimi i kërkesës/ të çdo kërkesë.*

Detyrimi i të paditurës për pagesën e kamatës dhe kamatëvonesës prej 8% në vit është gjykuar nga Gjykata konformnenit 382 të LMD/ Ligjinr. 04/L-077 i datës 10 maj 2012, në të cilën dispozitë është përcaktuar se „ *Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.*

Ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës, Gjykata e bazoi në nenin 452.1 të LPK-së, duke marrur parasysh suksesin e paditësit në kontest, ashtu që e detyroi të paditurën që t'ia kompenzoj paditësit shpenzimet në lartësi prej 270€, në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi edhe ate për përpilimin e padisë shumen prej 104€, taksa gjyqësore në lartësi prej 31€ dhe për një përfaqësim gjyqësor të avokatit 135 €.

Nga të cekurat më lartë, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të Aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr. 1967/2020, i datës 10.11.2021

G j y q t a r i,
Berat Spahiu

Udhëzim mbi Mjetin Juridik: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit, përmes kësaj Gjyka